



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në bazë të nenit 114 dhe nenit 37 paragrafi 6 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/18), nenit 163 dhe 349 paragrafi 6 të Statutit të Universitetit të Tetovës, si dhe nenit 52 dhe 103 paragrafi 6 të Statutit të Fakultetit Filologjik, Dekani i Fakultetit Filologjik solli:

V E N D I M

për shpalljen e zgjedhjeve të anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit Filologjik në Universitetin e Tetovës

Neni 1

Shpallen zgjedhje për anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit Filologjik në Universitetin e Tetovës.

Neni 2

Anëtarët e Kuvendit Studentor të Fakultetit zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, të ndershme dhe demokratike me votim të fshehtë.

Kryetari i Kuvendit Studentor të Fakultetit, zgjidhet në mbledhjen e pare konstituive të Kuvendit studentor, nga radhët e anëtarve të zgjedhur, në përputhje me Statutin e Kuvendit Studentor të Fakultetit

Neni 3

Zgjedhjet për anëtarët e Kuvendit Studentor të Fakultetit do të mbahen me votim të fshehtë më datë **09.07.2026** (e enjte), në sallën e mbledhjeve të Fakultetit, me fillim nga ora **08:30** deri në orën **16:30**.

Neni 4

Emërohet Komision Zgjedhor për realizimin e zgjedhjeve për anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit, në këtë përbërje:

- 1) **Doc. dr. Lindita SKENDERI** – mësimmhënëse në Fakultet – kryetar;
- 2) **Ass. mr. Osman ISMAILI** – mësimmhënëse në Fakultet – anëtare;
- 3) **Agnesa REXHEPI** – student në semestrin VIII viti i **katërt** studimeve në programin studimor **Gjuhë dhe Letërsi Angleze** në vitin akademik **2025/2026**, me numër indeksi **220556** – anëtare;
- 4) **Elma MAZLLAMI** – student në semestrin VIII viti i katërt studimeve në programin studimor **Gjuhë dhe Letërsi Angleze** në vitin akademik **2025/2026**, me numër indeksi **220096** – anëtare;
- 5) **Rona MUNISHI** – student në semestrin VIII viti i katërt studimeve në programin studimor **Gjuhë dhe Letërsi Angleze** në vitin akademik **2025/2026**, me numër indeksi **220649** – anëtare.

Neni 5

(1) Komisioni Zgjedhor nga neni 4 i këtij Vendimi:

- përcakton rregullat dhe miraton Udhëzuesin për procedurën e zhvillimit të zgjedhjeve;
- përcakton listën e kandidatëve të propozuar, bazuar në verifikimin paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u propozuar si anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit (nëse janë studentë aktivë, pra të regjistruar në semestrin/vitin në të cilin mbahen



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

zgjedhjet);

- e përcakton pamjen e fletës së votimit/formularëve të procesverbaleve, si dhe dokumentacionin tjetër që del nga rrjedha e procedurës për zhvillimin e zgjedhjeve;
- e përcakton mënyrën e votimit, numërimin e votave, dhe veprimin ndaj ankesave brenda një afati prej 24 orëve nga momenti i paraqitjes së tyre;
- kryen edhe detyra të tjera që lidhen me rrjedhën e zhvillimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit.

(2) Udhëzuesi i Komisionit Zgjedhor publikohet në tabelën e shpalljeve/façen zyrtare të Fakultetit, jo më vonë se 7 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, së bashku me Vendimin për listën e përcaktuar të kandidatëve studentë që i plotësojnë kushtet (lista përfundimtare).

Neni 6

(1) Kuvendi Studentor i Fakultetit përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues nga secili program studimor të njësive të Universitetit,

(2) Në rast se nuk plotësohet numri i anëtarëve për secilin program studimor, në përputhje me paragrafin e mëparshëm, për shkak të mungesës së studentëve që i plotësojnë kushtet, vendet e paplotësuara nuk përfshihen në numrin e përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit, pra ai do të përbëhet nga aq anëtarë sa ka studentë që i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur dhe që do të jenë të zgjedhur.

Neni 7

Të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur si anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit kanë të gjithë studentët e Fakultetit, të cilët janë të regjistruar në studime gjatë vitit akademik në të cilin zgjidhet Kuvendi Studentor i Fakultetit.

Neni 8

Anëtarë të zgjedhur të Kuvendit Studentor të Fakultetit konsiderohen ata kandidatë që kanë marrë numrin më të madh të votave nga studentët e Fakultetit që kanë votuar.

Neni 9

Komisioni Zgjedhor obligohet që t'i zhvillojë zgjedhjet në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit dhe Statutin e Kuvendit Studentor të Fakultetit.

Neni 10

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe publikohet në tabelën e shpalljeve/façen zyrtare të Fakultetit.

Tetovë, më 18. VI. 2026



Dekan i Fakultetit Filologjik

Prof. dr. Emine SHABANI